

Të dashur prindër

Urime për lindjen e fëmijës suaj! Me projektin Buchstart – libri i parë - duam t'ju shoqërojmë në rrugën e përbashkët në botën e gjuhës. Fëmija juaj gëzohet kur ju filloni të flisni me të dhe i lexoni përralla nga librat. Prandaj i dhurojmë çdo fëmijë në Zvicër një paketë me librin e parë.

Të zbulojmë së bashku gjuhën dhe tregimet

Duke lexuar me fëmijën forconi lidhjet tuaja me të. Kush u lexon fëmijëve, u dhuron atyre kohë, afërsi dhe ndjenjë. Fëmijët i adhurojnë këto momente. Leximi zhvillon fantazinë e fëmijës suaj, ai zbulon gjuhën dhe botën përmes saj. Fëmijët të cilëve u lexohen që të vegjël kanë fjalor më të madh dhe mësojnë më lehtë.

Të rritesh me libra

Udhëzimet e mëposhtme japin një pasqyrë, për çfarë interesohet fëmija juaj në cilën moshë dhe cilat aftësi zhvillon. Këto janë në përgjithësi, sepse çdo fëmijë është ndryshe.

6 muajsh

Bebja juaj mund të kapë një libër dhe ta kafshojë atë. Ajo do të zbulojë a mund të hahet apo jo, çfarë shije ka, a i pëlqen forma apo përmbajtja apo a ka ndonjë erë të veçantë. Që tani ai mund të dallojë edhe ngjyrat e forta.

12 muajsh

Fëmija juaj di tashmë, që sendi që mban në dorë është një libër dhe do ta shikojë së bashku me ju. Ai gëzohet kur shikon që të rriturit bëhet gati t'i lexojnë dhe mund të dallojë tani edhe figurat. Ndoshta përplas duart, kur e njuh librin. Ai fillon të kuptojë kur figurat janë me kokë poshtë.

18 muajsh

Libri është bërë objekt tashmë i njohur për fëmijën. Ai i mban ata me vete dhe shfleton vazhdimisht faqet duke treguar objektet në libër. Fëmija di si duhen parë figurat, por nuk e mban tamam në librin. Ai do që të jeni ju lexuesit e tij.

24 muajsh

Fëmija mund t'i shfletojë me rregull faqet e librit dhe të tregojë figurat për të cilat e pyesni. Ai mbaron fjalitë që filloni ju. Ai përsërit fraza të shkurtra nga historitë. Në këtë moshë fëmija përqëndrohet më gjatë për të dëgjuar. Ai «u lexon» kukullave, pellushëve dhe macës histori nga librat ose ato që i shpik vetë.

36 muajsh

Tashmë fëmija juaj di si të sillet me librat. Ai dëgjon me vëmendje gjatë leximit dhe vëren çdo shmangje nga rradha. Fëmija «i lexon» ato vetë me zë dhe kërkon faqet që i pëlqejnë më shumë.

Më vonë

Fëmija juaj tashmë është shumë i aftë të vrottojë. Ai mund t'i marrë me mend gjërat. Kështu ai mund t'ju kujtojë nëse keni harruar diçka. Shpesh do të përsërisë me fjalët e veta atë çfarë ka dëgjuar. Ju bën pyetje ju dhe vetes së tij, që të krijojë dialog dhe të fillojë biseda.

Librat në përditshmërinë e familjes tuaj

Rezervoni gjithmonë kohë të mjaftueshme për të zbuluar një libër me fëmijën tuaj. Jepini kohë fëmijës tuaj të shikojë figurat me vëmendje dhe ndiqni interesin e fëmijës. Lëni atë të shfletojë, t'ju bëjë pyetje dhe të shkëmbehet me ju. Lëni fëmijën t'ju drejtojë. Ndoshta ai do ta kapë librin, do të dëgjojë diçka, apo të shfletojë vetë. Flisni ngadalë dhe lëni kohë mjaftueshëm fëmijës të shikojë. Mos prisni më shumë se disa minuta përqëndrim. Me kalimin e kohës kjo do të ndryshojë. Fëmija juaj do bëhet gjithmonë e më aktiv, do të flasë fjalët e para dhe të bëjë pyetje.

Mirësevini në bibliotekë

Në bibliotekë do të gjeni shumë libra që mezi presin t'i zbuloni. Aty ka edhe shumë aktivitete për fëmijë të vegjël. Ju do të këndonin bashkë, do të lexoni vargje dhe përralla. Ju mund të merrni pjesë gjithmonë dhe të frymëzoheni.

Kush fshihet pas Buchstart?

Buchstart zhvillohet në të gjithë Zvicrën me ndihmën e Bibliomediës dhe Institutit për fëmijë dhe të rinj SIKJM.

www.bibliomedia.ch

www.sikjm.ch, www.isjm.ch, www.ismr.ch

Informacione të mëtejshme: www.buchstart.ch,
www.nepourlire.ch, www.natiperleggere.ch

Albanisch / Albanais / Albanese



Buchstart
Né pour lire
Nati per leggere
Naschi per leger